



Prishtinë, 15 tetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1053_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_840_2016 të datës 3 tetor 2016 për shoqërinë "Frigo Food Kosovë" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Gjakovës;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_840_2016 të datës 3 tetor 2016 edhe për muaj (3) muaj, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Gjakovës, të datës 21.09.2018 nr. prot. 433/18 të shoqërisë "Frigo Food Kosovë" SH.P.K.me adresë: rr. "Lidhja e Prizrenit" OB. Dino,Lam A.28, nr. 4 Fushë Kosovë, Republika e Kosovës, dhe

në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Frigo Food Kosovë" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_840_2016 të datës 3 tetor 2016 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej **3 MW**, komuna e Gjakovës, edhe për tre (3) muaj, gjegjësisht deri me 3 janar 2019 për ndërtimin e parkut solar fotovoltaik, sipas Lejes së Ndërtimit nr. 07/351-39698 të datës 17.08.2016 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gjakovës.

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 04.11.2014 nga shoqëria "Frigo Food Kosovë" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panele solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Gjakovës, Republika e Kosovës.
- o Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria Frigo Food Kosovë" SH.P.K., në seancën e mbajtur me datë 20 shkurt 2015 ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve



të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nr. V_704_2015.

- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 26.01.2016 ka pranuar nga shoqëria “Frigo Food Kosovë” SH.P.K., kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi njoftimin për Autorizimin Preliminar V_704_2015 të datës 20 shkurt 2015, edhe për një afat shtesë ligjor, për të kompletuar aplikacionin për marrjen e Autorizimit Final.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në seancën e mbajtur me datë 23 shkurt 2016 ka vlerësuar kërkesën e aplikuesit dhe ka lëshuar vendimin nr. V_792_2016 për shtyrjen e vlefshmërisë së afatit të vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_704_2015 të datës 20 shkurt 2015, edhe për 6 (gjashtë) muaj, gjegjësisht deri me **20 gusht 2016**.
- ZRRE me datë 19.08.2016 nga shoqëria “Frigo Food Kosovë” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Gjakovës, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga Komuna e Gjakovës dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 3 tetor 2016, pas vlerësimit dhe analizimit të kërkesave sipas aplikacionit dhe lejeve të lëshuara nga institucionet relevante, ka vendosur që shoqërisë “Frigo Food Kosovë” SH.P.K., ti lëshohet Vendimi për Autorizimin FINAL V_840_2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar kapaciteti i instaluar prej 3 MW, komuna e Gjakovës sipas Lejes së Ndërtimit nr. 07/351-39698 të datës 17.08.2016 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Gjakovës.
- ZRRE me datë, 21.09.2018 nga shoqëria “Frigo Food Kosovë” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_840_2016 të datës 3 tetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, **edhe për tre (3) muaj, gjegjësisht deri me 3 janar 2019 për finalizimin e projektit solar/fotovoltaik.**
- Shoqëria “Frigo Food Kosovë” SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: janë në fazën përfundimtare të projektit, në fakt janë përfunduar të gjitha punët e instalimit dhe kanë filluar testimet e para të brendshme. Poashtu kanë sqaruar se kanë organizuar takim me zyrtarët e Komunës së Gjakovës, në lidhje me lëshimin e certifikatës së përdorimit, e cila është duke marr kohë në lëshimin e lejes përkatëse të përdorimit. Projekti në fjalë ka pasur vonesa për arsye



jashtë ndikimit të kompanisë, të cilat kanë marr kohë derisa janë zgjidhur, ku traseja e lart përçuesit prej 6 km për kyçe deri te Nënstacioni Gjakova 1, ka kaluar nëpër shumë prona të ndryshme dhe është nevojitur shumë kohë derisa është marr miratimi i pronarëve për kalimin në pronat e tyre, gjithmonë duke pasur parasysh edhe mentalitetin tonë dhe relacionin me pronën, ka paraqitur një sfidë të jashtëzakonshme. Poashtu kanë ndikuar edhe kushtet klimatike gjatë këtij viti ku ka pasur të reshura të mëdha të cilat kanë zvogëluar edhe ditët e punës.


- Andaj, duke qenë të bindur se projekti në fjalë mund të lëshohet në punë gjatë muajit tetor 2018, shoqëria "Frigo Food Kosovë" SH.P.K., kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së, që në pajtim me dispozitat ligjore të nenin 16 par. 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, që t'iu mundoj shtyrjen e vlefshmërisë së autorizimit edhe për tre (3) muaj, gjegjësisht deri me 3 janar 2019.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "Frigo Food Kosovë" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, në vendin e quajtur Madanaj ZK Kusar, me kapacitet të instaluar prej 3 MW, Komuna e Gjakovës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të gjendjen në teren, ka konstatuar se projekti do të finalizohet brenda kësaj periudhe dhe ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_840_2016 i datës 03 tetor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_840_2016 i datës 3 tetor 2016, do të vlen deri me datë **3 janar 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese panelet solare/fotovoltaike, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar